

	REPUBLIKA E KOSOVËS REPUBLIKA KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVA KOMUNA E RAHOVECIT OPSTINA ORAHOVAC MUNICIPALITY OF RAHOVEC	
---	---	---

Për:	Grup i Operatorëve Ekonomik: ENG IDEA SH.P.K.; ARCH EMPIRE L.L.C.; GeoMetri SH.P.K. , Brigada 123, 23000, Suhareke Operatorëve Ekonomik Të gjitha palëve të interesuar
Nga:	Astrit Mullabazi, Menaxher i Zyrës së Prokurimit
Lënda:	VENDIM për Rishqyrtim të Kërkesës
Datë:	30.07.2026

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Rahovecit, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, si dhe duke u bazuar në nenin 63 paragrafi 1 të Rregullores Nr. 001/2022 për Prokurim Publik, sa i përket **Kërkesës për Rishqyrtim** të datës: **28.07.2026**, të parashtruar nga Grup i Operatorëve Ekonomik: **ENG IDEA SH.P.K.; ARCH EMPIRE L.L.C.; GeoMetri SH.P.K.**, me adresë në **Suhareke**, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **Hartimi i projekteve të ndryshme**, me Numër të prokurimit: **623-26-2856-2-1-1**, Numër i brendshëm: **623-26-015-2-1-1**, nxjerr:

V E N D I M

- I. **REFUZOHET** e pa bazuar kërkesa e parashtruar nga Grup i Operatorëve Ekonomik: **ENG IDEA SH.P.K.; ARCH EMPIRE L.L.C.; GeoMetri SH.P.K.**, me adresë në **Suhareke**, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **Hartimi i projekteve të ndryshme**, me Numër të prokurimit: **623-26-2856-2-1-1**, Numër i brendshëm: **623-26-015-2-1-1**, kundër Njoftimit mbi Vendimin e AK-së, të datës: **23.07.2026**, të publikuar në ueb-faqe: <https://e-prokurimi.rks-gov.net>
- II. Autoriteti Kontraktues vendos të vazhdoj me Njoftim Mbi Vendimin e Autoritet Kontraktues për aktivitetin e prokurimit, me Numër të prokurimit: **623-26-2856-2-1-1**, Numër i brendshëm: **623-26-015-2-1-1**
- III. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet për të gjitha palët në platformën elektronik në adresën: <https://e-prokurimi.rks-gov.net>

A r s y e t i m

Grup i Operatorëve Ekonomik: **ENG IDEA SH.P.K.; ARCH EMPIRE L.L.C.; GeoMetri SH.P.K.**, me adresë në **Suhareke**, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **Hartimi i projekteve të ndryshme**, me Numër të prokurimit: **623-26-2856-2-1-1**, Numër i brendshëm: **623-26-015-2-1-1**, kundër Njoftimit mbi Vendimin e AK-së, të datës: **23.07.2026**, të publikuar në ueb-faqe: <https://e-prokurimi.rks-gov.net>, ka bërë Kërkesë për Rishqyrtim me datë: **28.07.2026**, sipas nenit 108/A, të Ligjit për Prokurimin Publik (LPP) me Nr. 04/L-042.

Baza Ligjore për Refuzim të Kërkesës

Ju sqarojmë se pretendimet e tua ankimor nuk qëndrojnë dhe janë të pabazuara, pasi që vlerësimi i ofertave është bërë konform Ligjit Nr. 04/042, Ligji për Prokurimin Publik

Autoriteti Kontraktues: Komuna e Rahovecit, ju ka Njoftuar juve si Operator Ekonomik ankues, sipas formularit **B42 Letër Standarde për tenderuesin e eliminuar**, ku kemi cekur:

Tenderi juaj është refuzuar për këto arsye:

ARSYETIM 1

Ju njoftojmë se ju si Grup i Operatorëve Ekonomikë (GOE) nuk i keni përmbushur të gjitha kërkesat e përcaktuara në Dosjen e Tenderit dhe Njoftimin për Kontratë, përkatësisht kërkesat që lidhen me kapacitetin teknik dhe profesional të stafit të propozuar.

Konkretisht, në Dosjen e Tenderit dhe Njoftimin për Kontratë, në kuadër të **Kapacitetit Teknik dhe Profesional**, për pozitën:

Kërkesa 2.5 – Një Inxhinier i Diplomuar në Inxhinieri Elektroteknike ose Master, me përvojë pune në projektim minimum 3 (tre) vite pas diplomimit;

është kërkuar si dëshmi dokumentare: ***“CV-në (të nënshkruar nga vetë pala)”***

Gjatë shqyrtimit të dokumentacionit të ofertës është konstatuar se për inxhinierin e elektroteknikës, **z. Xhevdet Sejdiu**, CV-ja e dorëzuar nuk është e nënshkruar nga vetë inxhinieri, siç është kërkuar shprehimisht në Dosjen e Tenderit.

Po ashtu, për pozitën:

Kërkesa 2.8 – Një ekspert të licencuar për hartimin e elaboratit të EMZ-së, me përvojë pune profesionale minimum 3 (tre) vite pas diplomimit;

është kërkuar si dëshmi dokumentare: ***“CV-në (të nënshkruar nga vetë pala)”***

Gjatë vlerësimit është konstatuar se për ekspertin e EMZ-së, **z. Ramush Hajdari**, CV-ja e paraqitur nuk është e nënshkruar nga vetë eksperti, në kundërshtim me kërkesën e përcaktuar në Dosjen e Tenderit.

Komisioni i Vlerësimit vlerëson se kërkesa për nënshkrimin e CV-së nga vetë personi i propozuar është kërkesë e qartë dhe obligative e Dosjes së Tenderit, e cila shërben për të konfirmuar saktësinë e të dhënave të paraqitura dhe pranimin e angazhimit nga personi përkatës në realizimin e kontratës.

Meqenëse për stafin e lartcekur nuk janë paraqitur CV-të e nënshkruara nga vetë personat e propozuar, siç është kërkuar shprehimisht në Dosjen e Tenderit dhe Njoftimin për Kontratë, Komisioni i Vlerësimit konstaton se operatori ekonomik nuk ka dëshmuar përmbushjen e plotë të kërkesave minimale të kapacitetit teknik dhe profesional.

Prandaj, duke u bazuar në **nenin 59.4 të Ligjit për Prokurimin Publik**, Komisioni i Vlerësimit ka vendosur që ofertën e Grupit të Operatorëve Ekonomikë ta konsiderojë si **Ofertë të Papërgjegjshme**.

ARSYETIM 2

Në pajtim me Nenin 87, paragrafin 2, nën paragrafin 2.8 dhe nenin 61, paragrafin 4, të Ligjit mbi Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092, vlera e ofruar nga GOE është normalisht e ulët. Në pajtim me Nenin 3, konkretisht pika 3.2 të Rregullat për Tenderët Jo-Normalisht të Ulët, nenin 41 konkretisht neni 41.6 të Rregullores NR.001/2022 Për Prokurim Publik dhe nenin 61 konkretisht 61.4 ligjit të LPP-së.

Pas analizimit dhe shqyrtimit të Ofertës Financiare të dorëzuar nga GOE, Komisioni i Vlerësimit ka vlerësuar se në ofertën e dorëzuar në disa pozicioneve ju si GOE keni ofertuar me çmime abnormalisht të ulëta, konkretisht si më poshtë:

- Pozicioni **I.B.6 Punimi i Projektit Kryesor – Ashensorëve** ju keni vendosur çmimin 0.50€/Copë.
- Pozicioni **I.D.5 Hartimi i Projektit për Rregullimin e Nyjeve të Trafikut (Kryqëzimeve Rrugore)** ju keni vendosur çmimin 0.02€/Copë.
- Pozicioni **I.D.6 Hartimi i Elaboratit të Shpronësimit për Projektet Rrugore** ju keni vendosur çmimin 0.02€/Copë.
- Pozicioni **I.D.12 Punimi i Elaboratit Gjeomekanik** ju keni vendosur çmimin 0.05€/m thellësi.
- Pozicioni **I.E.4 Hartimi i Projektit Kryesor për Rezervuarët e Ujit dhe Kaptazhet (Burimet)** ju keni vendosur çmimin 0.25€/m³.
- Pozicioni **I.E.6 Hartimi i Projektit Kryesor – Gropat Septike** ju keni vendosur çmimin 0.04€/copë.
- Pozicioni **I.E.8 Hartimi i Projektit Ideor – Impianti për Trajtimin e Ujërave të Zeza (deri 2500 Banorë Ekuivalent – PE)** ju keni vendosur çmimin 0.01€/copë.
- Pozicioni **I.E.9 Hartimi i Projektit kryesor – Impianti për Trajtimin e Ujërave të Zeza (deri 2500 Banorë Ekuivalent – PE)** ju keni vendosur çmimin 0.02€/copë.
- Pozicioni **I.F.1 Projektimi i Lëshesave Pllakore me hapësirë drite prej 2–5 m** ju keni vendosur çmimin 0.02€/copë.
- Pozicioni **I.F.2 Projektimi i Mbikalimeve dhe Nënkalimeve** ju keni vendosur çmimin 0.02€/copë.
- Pozicioni **I.F.4 Projektimi i Urave me hapësirë drite deri 15 m** ju keni vendosur çmimin 0.02€/copë.
- Pozicioni **I.F.5 Projektimi i Urave me hapësirë drite mbi 15 m** ju keni vendosur çmimin 0.02€/copë.

Çmime këto të cilat janë trajtuar si çmime jo normalisht të ulëta, për të cilat komisioni ka kërkuar nga Zyrtari i Prokurimit që në harmoni me **nenin 3.2 të Rregullat për Tenderët Jo-Normalisht të Ulët** dhe duke u bazuar në **nenin 41.6 të Rregullores NR.001/2022** të kërkojë sqarim shtesë të GOE rreth çmimeve të ofruara.

Brenda afatit të përcaktuar nga Autoriteti Kontraktues, Grupi Operatoreve Ekonomikë (GOE) ka dorëzuar sqarimet dhe arsyetimet e kërkuara lidhur me çmimet e ofertuara. Komisioni i Vlerësimit ka shqyrtuar me kujdes të gjitha sqarimet dhe dokumentacionin e paraqitur, mirëpo ka konstatuar se arsyetimet e ofruara nuk janë të mjaftueshme dhe nuk dëshmojnë në mënyrë bindëse realizueshmërinë e çmimeve të ofertuara për pozicionet e evidentuara.

Pas analizës së detajuar të përgjigjeve të dorëzuara, Komisioni i Vlerësimit ka vlerësuar se operatori ekonomik nuk ka arritur të argumentojë në mënyrë të besueshme dhe të dokumentuar strukturën e kostove dhe realizueshmërinë e çmimeve të ofertuara.

Komisioni i Vlerësimit, pas shqyrtimit të ofertës, përshtimit të çmimeve, analizës së tregut dhe sqarimeve të dorëzuara nga GOE, ka konstatuar se ekzistojnë prova dhe indikacione të mjaftueshme

që oferta përmban çmime jo-normalisht të ulëta në një numër të konsiderueshëm pozicionesh, të evidentuara në analizën e çmimeve dhe në kërkesën për sqarime.

Komisioni i vlerësimit të ofertave, pas shqyrtimit të argumenteve të paraqitura në përshkrimin e çmimeve, ka vlerësuar se ka prova të mjaftueshme që oferta juaj është ofertë me çmime jo-normalisht të ulëta. Në harmoni me Ligjin për Prokurim Publik të Kosovës, veçanërisht në bazë të **nenit 41.6** të Rregullores për Prokurim Publik Nr. 001/2022, dhe vendimeve të mëparshme të Panelit Shqyrtues, komisioni për vlerësimin e ofertave ka konstatuar se ka vepruar në harmoni me këto dispozita duke konstatuar se oferta në fjalë e GOE është ofertë me çmime jo-normale të ulëta në shumë pozicione të cilat janë evidentuar në Përshkrim të Çmimeve.

Gjatë marrjes së vendimit, komisioni i vlerësimit ka marrë në konsideratë edhe praktikën e vendimeve të mëparshme të Organit Shqyrtues të Prokurimit, përkatësisht vendimet e Panelit Shqyrtues me nr. **PSH 1034/23, datë 07.02.2024, PSH 2024/0431, datë 03.07.2024, PSH 2024/0674, datë 25.09.2024**, në të cilat janë trajtuar dhe vlerësuar çështjet që lidhen me ofertat me çmime jo-normalisht të ulëta në pozicione të ndryshme të shërbimeve të projektimit dhe shërbimeve profesionale.

Në përputhje me **nenin 41.6** të Rregullores Nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, si dhe duke u mbështetur në praktikën e lartcekur të Panelit Shqyrtues, Komisioni i Vlerësimit ka vendosur që oferta e Grupit të Operatorëve Ekonomikë të konsiderohet si **Ofertë e Papërgjegjshme**.

ARSYETIM 3

Ju njoftojmë se ju si Grup i Operatoreve Ekonomikë (GOE) nuk i keni përmbushur të gjitha kërkesat e përcaktuara në Dosjen e Tenderit dhe Njoftimin për Kontratë, përkatësisht kërkesat që lidhen me kapacitetin teknik dhe profesional tek kërkesa e pajisjeve.

Konkretisht, në Dosjen e Tenderit dhe Njoftimin për Kontratë, në kuadër të **Kapacitetit Teknik dhe Profesional për pajisjen:**

Kërkesa 6 Një (1) PAISJE GJEODEZIKE GPS GNSS RTK-Advanced Engine System me minimum 1408 kanale satelitore, me dual kamerë në kokë-resiver, controller Handy me kamerë në kontroll- terminal, me opsion rilevimi 3D me fotografi (fotogrametri) dhe me laser, mundësinë e modelimit 3D dhe piketimi real view me kamerë është kërkuar si dëshmi dokumentare

Dëshmia 6. Për paisjen të prezantohet dokumenti i pronësis (DUD doganor apo fature blerje) ose marreveshje per qira e nënshkruar tek noteri. Të prezantohet specifikacioni nga prodhuesi i paisjes.

Grupi i Operatorieve ka paraqitur paisjen hi-target V600l, e cila paisje nuk ploteson kushtin “**me opsion rilevimi 3D me fotografi (fotogrametri) dhe me mundësinë e modelimit 3D**”

Sipas prodhuesit, paisja e paraqitur ka mundësi të matjes me laser, por jo edhe rilevim me fotogrametri dhe modelim 3D. Kamera qe posedon paisja sherben vetem per piketim-orientim ne natyre ndersa jo per fotogrametri.

Prandaj, duke u bazuar në **nenin 59.4 të Ligjit për Prokurimin Publik**, Komisioni i Vlerësimit ka vendosur që ofertën e Operatorit Ekonomikë ta konsiderojë si **Ofertë të Papërgjegjshme**.

PËRGJIGJE PËR PRETENDIMET ANKIMORE TË GRUPIT TË OPERATORËVE

EKONOMIK

ENG IDEA SH.P.K.; ARCH EMPIRE L.L.C.; GeoMetri SH.P.K., Brigada 123, 23000, **Suhareke**

PËRGJIGJE PËR PRETENDIMIN ANKIMORE NR 1.

Autoriteti Kontraktues, në Dosjen e Tenderit dhe Njoftimin për Kontratë, konkretisht në kuadër të **Kapacitetit Teknik dhe Profesional**, ka përcaktuar qartë kërkesat minimale për stafin profesional, përkatësisht:

- **Kërkesa 2.5** – Një Inxhinier i Diplomuar në Inxhinieri Elektroteknike ose Master, me përvojë pune në projektim minimum 3 vite pas diplomimit;
- **Kërkesa 2.8** – Një ekspert të licencuar për hartimin e elaborative të EMZ-së, me përvojë pune profesionale minimum 3 vite pas diplomimit.

Për përmbushjen e këtyre kërkesave, si dëshmi dokumentare është kërkuar, ndër të tjera:

- Diploma përkatëse – kopje;
- Kontrata e rregullt e punës me punëdhënësin ose marrëveshja mbi angazhim për këtë projekt, e përpiluar në përputhje me Ligjin e Punës Nr. 03/L-212;
- **CV-ja e nënshkruar nga vetë pala;**
- Letër reference për punët e mëparshme në lëmin e kërkuar, e lëshuar nga punëdhënësi.

Gjatë shqyrtimit dhe vlerësimit të ofertës është konstatuar se për inxhinierin e elektroteknikës, z. **Xhevdet Sejdiu**, CV-ja e dorëzuar **nuk është e nënshkruar nga vetë inxhinieri**, ndonëse nënshkrimi i CV-së ka qenë kërkesë e qartë dhe e detyrueshme e Dosjes së Tenderit dhe njoftimit për kontratë.

*Bazuar në tabelarin e **UDHËZUES Nr. 001/2023 PËR PROKURIMIN PUBLIK, Neni 10:***

Sqarimi i tenderëve gjatë procesit të vlerësimit të tenderëve thotë:

CV-ja e dorëzuar nuk përmbush kërkesat	Refuzo tenderin pa kërkuar informacion të mëtjshëm	69
--	--	----

Po ashtu, është konstatuar se edhe për ekspertin e licencuar për hartimin e elaborative të EMZ-së, z. **Ramush Hajdari**, CV-ja e paraqitur **nuk është e nënshkruar nga vetë eksperti**, në kundërshtim me kërkesën e përcaktuar në Dosjen e Tenderi dhe njoftimit për kontratë.

*Bazuar në tabelarin e **UDHËZUES Nr. 001/2023 PËR PROKURIMIN PUBLIK, Neni 10:***

Sqarimi i tenderëve gjatë procesit të vlerësimit të tenderëve thotë:

CV-ja e dorëzuar nuk përmbush kërkesat	Refuzo tenderin pa kërkuar informacion të mëtjshëm	69
--	--	----

Komisioni i vlerësimit gjatë rishqyrtimi vlerëson se mosplotësimi i kësaj kërkesë përbën mos përmbushje të një kriteri të përcaktuar shprehimisht në Dosjen e Tenderit dhe njoftimit për kontratë.

Dosja e Tenderit nuk ka kërkuar thjesht një CV, por ka kërkuar në mënyrë eksplicite: "**CV-në (të nënshkruar nga vetë pala).**" Kjo do të thotë se elementi i kërkuar nuk ishte vetëm ekzistenca e CV-së, por edhe forma në të cilën ajo duhej të dorëzohej. Grupi i operatoreve ekonomik nuk e ka përmbushur këtë kërkesë në momentin e dorëzimit të ofertës.

Pretendimi i Grupit të operatoreve ekonomik se **versionet e nënshkruara të CV-ve kanë ekzistuar para afatit për dorëzimin e ofertave**, por janë ngarkuar gabimisht versionet e panënshkruara gjatë procesit elektronik, nuk mund të merret për bazë për ndryshimin e vendimit.

Autoriteti Kontraktues është i obliguar të vlerësojë ofertat vetëm mbi bazën e dokumentacionit të dorëzuar në platformën elektronike brenda afatit të përcaktuar për dorëzimin e ofertave. Përgjegjësia për përgatitjen, verifikimin dhe ngarkimin e dokumentacionit të ofertës bie ekskluzivisht mbi grupin e operatoreve ekonomik dhe pas skadimit të afatit për ofertim nuk mund të korrigjohen apo zëvendësohen dokumentet që nuk janë dorëzuar në formën e kërkuar.

Komisioni nuk vlerëson dokumente që pretendohet se kanë ekzistuar, por vetëm ato që janë dorëzuar në platformën elektronike deri në afatin e ofertimit.

Nëse do të pranohej një arsyetim i tillë, çdo operator ekonomik pas hapjes së ofertave do të mund të pretendonte se kishte dokumente të tjera të nënshkruara por kishte ngarkuar gabimisht versionin e gabuar. Kjo do të cenonte trajtimin e barabartë, transparencën, integritetin e procedurës.

Po ashtu, nuk mund të pranohet pretendimi se marrëveshjet e bashkëpunimit të nënshkruara nga ekspertët e zëvendësojnë kërkesën për CV të nënshkruar. Dosja e Tenderit ka kërkuar veçmas marrëveshjen e angazhimit dhe veçmas CV-në e nënshkruar nga vetë pala. Këto janë dokumente të ndryshme me funksione të ndryshme dhe njëri dokument nuk mund ta zëvendësojë tjetrin.

Komisioni i Vlerësimit është i obliguar t'i vlerësojë ofertat vetëm mbi bazën e dokumentacionit të dorëzuar deri në afatin për ofertim dhe nuk ka të drejtë të neglizhojë apo të interpretojë në mënyrë selektive kërkesat e Dosjes së Tenderit, pasi një veprim i tillë do të binte ndesh me parimin e trajtimit të barabartë të operatorëve ekonomikë dhe transparencës në procedurën e prokurimit.

Autoriteti Kontraktues gjithashtu nuk pajtohet me pretendimin se në këtë rast bëhet fjalë vetëm për një mangësi formale e cila mund të korrigjohet në bazë të nenit 59 të Ligjit për Prokurimin Publik dhe nenit 45 të Rregullores Nr. 001/2022. Dispozitat e lartcekura lejojnë vetëm sqarimin e dokumentacionit të dorëzuar dhe nuk autorizojnë Autoritetin Kontraktues që, pas skadimit të afatit për dorëzimin e ofertave, të pranojë versione të reja të dokumenteve ose dokumente të plotësuar që nuk janë dorëzuar në formën e kërkuar nga Dosja e Tenderit. Pranimi i CV-ve të nënshkruara gjatë fazës së rishqyrtimit do të përbënte korrigjim dhe zëvendësim të dokumentacionit të ofertës pas afatit të ofertimit, gjë që do të binte ndesh me parimet e trajtimit të barabartë, transparencës dhe integritetit të procedurës së prokurimit dhe bie ndesh **Neni 72, paragrafi 3. ku thotë: Sigurimi i informacionit qe**

mungon ose ofrimi i informacionit do të aplikohet vetëm për dokumentet ekzistenca e të cilave është e fiksuar, para skadimit të afatit për dorëzimin e tenderëve, dhe mund të verifikohet në mënyrë objektive.

Po ashtu, deklaratat e ekspertëve dhe versionet e nënshkruara të CV-ve të bashkëngjitura kërkesës për rishqyrtim nuk kanë qenë pjesë e ofertës së dorëzuar brenda afatit ligjor dhe, si të tilla, nuk mund të merren në konsideratë për të provuar përmbushjen e një kriteri të kualifikimit pas përfundimit të afatit për dorëzimin e ofertave.

Për rrjedhojë, Komisioni i Vlerësimit ka vepruar në përputhje me kërkesat e Dosjes së Tenderit dhe me dispozitat e Ligjit për Prokurimin Publik, duke e bazuar vlerësimin vetëm në dokumentacionin e dorëzuar në kohë nga operatori ekonomik.

Prandaj, pretendimi ankimor lidhur me këtë pikë refuzohet si i pabazuar.

PËRGJIGJE PËR PRETENDIMIN ANKIMORE NR 2.

Ju sqarojmë se gjatë rishqyrtimit komisioni i vlerësimit ka zhvilluar procedurën e shqyrtimit të ofertës në përputhje me Ligjin për Prokurimin Publik dhe Rregulloren Nr. 001/2022 për Prokurimin Publik. Pas identifikimit të një numri të konsiderueshëm të pozicioneve me çmime që ngritnin dyshime të arsyeshme për realizueshmërinë e kontratës, Grupit të operatoreve ekonomik i është dhënë mundësia të paraqesë sqarime dhe argumente për strukturën e çmimeve të ofruara.

Komisioni i Vlerësimit ka shqyrtuar në tërësi sqarimet e dorëzuara nga grupi i operatoreve ekonomik, përfshirë metodologjinë e pretenduar të llogaritjes së çmimeve, organizimin e realizimit të shërbimeve, përvojën e mëparshme, si dhe pretendimin se pozicionet e kontestuar janë elemente përbërëse të projektit bazë. Megjithatë, pas analizimit të këtyre sqarimeve, komisioni ka konstatuar se ato nuk ofrojnë prova objektive dhe të mjaftueshme që eliminojnë dyshimet e arsyeshme lidhur me realizueshmërinë e çmimeve të ofertuara.

Pretendimi se çmimet për pozicionet e kontestuar janë përfshirë në çmimet e përgjithshme të projektimit nuk e përjashton detyrimin e operatorit ekonomik që të ofertojë çmime reale dhe ekonomiksht të arsyeshme për secilin pozicion të Përshkrimit të Çmimeve. Përshkrimi i Çmimeve është pjesë përbërëse e Dosjes së Tenderit dhe përfaqëson bazën mbi të cilën Autoriteti Kontraktues vlerëson ofertat dhe administron kontratën. Operatorët ekonomikë kanë qenë të obliguar të plotësojnë secilin pozicion në mënyrë të pavarur dhe në përputhje me kërkesat e Dosjes së Tenderit.

Pretendimi se paramasat apo elementet e projektimit janë ndarë në njësi të ndryshme matëse nuk ndryshon faktin se grupi i operatorëve ekonomik ka paraqitur çmime jo normalisht të ulëta në një numër të konsiderueshëm pozicionesh. Nëse grupi I operatorëve ekonomik ka konsideruar se struktura e Përshkrimit të Çmimeve ishte e paqartë, ai ka pasur të drejtë ta kontestojë Dosjen e Tenderit brenda afateve ligjore, para dorëzimit të ofertës. Pas dorëzimit të ofertës nuk mund të kontestohet metodologjia e hartimit të paramasës si arsyetim për çmimet e ofruara.

Pretendimi se operatori ekonomik ka realizuar kontrata të ngjashme në të kaluarën, përfshirë kontrata me Autoritetin Kontraktues, nuk është vendimtar për vlerësimin e kësaj procedure të prokurimit. Çdo procedurë zhvillohet në mënyrë të pavarur dhe vlerësimi

bëhet mbi bazën e dokumentacionit dhe ofertës së paraqitur në procedurën konkrete. Përvoja e mëparshme nuk përbën në vetvete provë se çmimet e ofertuara në këtë procedurë janë të realizueshme.

Gjithashtu, pretendimi se Autoriteti Kontraktues ka ndjekur praktikë të ndryshme në një procedurë tjetër të prokurimit nuk ndikon në ligjshmërinë e vendimit të marrë në këtë procedurë. Çdo procedurë e prokurimit ka karakteristikat e veta specifike, ndërsa Komisioni i Vlerësimit është i obliguar të vlerësojë secilën ofertë mbi bazën e dokumentacionit të dorëzuar, kërkesave të Dosjes së Tenderit dhe dispozitave të zbatueshme ligjore.

Për më tepër, Komisioni i Vlerësimit ka identifikuar një numër të konsiderueshëm pozicionesh në Përshkrimin e Çmimeve, për të cilat grupi I operatorëve ekonomik ka ofertuar çmime simbolike, të cilat në mënyrë objektive krijojnë dyshime të arsyeshme për realizueshmërinë e shërbimeve të kërkuara.

Ndër të tjera janë evidentuar këto pozicione:

- Pozicioni **I.B.6 – Punimi i Projektit Kryesor – Ashensorëve**, me çmim **0.50 €/copë**;
- Pozicioni **I.D.5 – Hartimi i Projektit për Rregullimin e Nyjeve të Trafikut (Kryqëzimeve Rrugore)**, me çmim **0.02 €/copë**;
- Pozicioni **I.D.6 – Hartimi i Elaboratit të Shpronësimit për Projektet Rrugore**, me çmim **0.02 €/copë**;
- Pozicioni **I.D.12 – Punimi i Elaboratit Gjeomekanik**, me çmim **0.05 €/m thellësi**;
- Pozicioni **I.E.4 – Hartimi i Projektit Kryesor për Rezervuarët e Ujit dhe Kaptazhet (Burimet)**, me çmim **0.25 €/m³**;
- Pozicioni **I.E.6 – Hartimi i Projektit Kryesor – Gropat Septike**, me çmim **0.04 €/copë**;
- Pozicioni **I.E.8 – Hartimi i Projektit Ideor – Impianti për Trajtimin e Ujërave të Zeza (deri 2500 PE)**, me çmim **0.01 €/copë**;
- Pozicioni **I.E.9 – Hartimi i Projektit Kryesor – Impianti për Trajtimin e Ujërave të Zeza (deri 2500 PE)**, me çmim **0.02 €/copë**;
- Pozicioni **I.F.1 – Projektimi i Lëshesave Pllakore me hapësirë drite 2–5 m**, me çmim **0.02 €/copë**;
- Pozicioni **I.F.2 – Projektimi i Mbikalimeve dhe Nënkalimeve**, me çmim **0.02 €/copë**;
- Pozicioni **I.F.4 – Projektimi i Urave me hapësirë drite deri 15 m**, me çmim **0.02 €/copë**;
- Pozicioni **I.F.5 – Projektimi i Urave me hapësirë drite mbi 15 m**, me çmim **0.02 €/copë**.

Nga analiza e këtyre pozicioneve rezulton se çmimet e ofertuara janë në nivele simbolike dhe nuk pasqyrojnë koston reale të angazhimit të stafit profesional, analizave teknike, projektimit, koordinimit, kontrollit të cilësisë dhe përgjegjësisë profesionale që kërkohen për realizimin e këtyre shërbimeve. Vetë pretendimi i operatorit ekonomik se këto shërbime janë "përfshirë" në pozicione të tjera të ofertës konfirmon se çmimet e vendosura për këto pozicione nuk përfaqësojnë vlerën reale të shërbimeve të kërkuara, por janë çmime jo reale të vendosura vetëm për efekt të plotësimit të Përshkrimit të Çmimeve.

Autoriteti Kontraktues nuk e konteston të drejtën e grupit të operatorëve ekonomik të organizojë strukturën e kostove të tij sipas politikave të brendshme, mirëpo kjo nuk e përjashton detyrimin që secili pozicion i Përshkrimit të Çmimeve të përmbajë një çmim real, të arsyeshëm dhe të mbështetur në shpjegime bindëse. Në rastin konkret, sqarimet e paraqitura nuk arritën të dëshmojnë se si shërbime profesionale të kësaj natyre mund të realizohen me çmime prej **0.01 €, 0.02 €, 0.04 € apo 0.05 €**, pa cenuar realizueshmërinë e kontratës.

Komisioni i Vlerësimit, gjatë marrjes së vendimit, është mbështetur në nenin 41.6 të Rregullores Nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, duke analizuar në mënyrë të hollësishme përshkrimin e çmimeve, analizën e tregut dhe sqarimet e grupit të operatorëve ekonomik. Gjithashtu, Komisioni ka marrë në konsideratë praktikën e konsoliduar të Organit Shqyrtues të Prokurimit, përkatësisht vendimet nr. **PSH 1034/23, datë 07.02.2024, PSH 2024/0431, datë 03.07.2024, PSH 2024/0674, datë 25.09.2024**, në të cilat është theksuar se, kur sqarimet e operatorit ekonomik nuk janë të mjaftueshme për të eliminuar dyshimet e arsyeshme mbi realizueshmërinë e ofertës, Autoriteti Kontraktues ka të drejtë ta konsiderojë ofertën si ofertë me çmime jo-normalisht të ulëta dhe, rrjedhimisht, si ofertë të papërgjegjshme.

Për rrjedhojë, Autoriteti Kontraktues vlerëson se Komisioni i Vlerësimit ka vepruar në përputhje me Ligjin për Prokurimin Publik, Rregulloren Nr. 001/2022 dhe praktikën e konsoliduar të Organit Shqyrtues të Prokurimit, ndërsa pretendimet e grupit të operatorëve ekonomik nuk përmbajnë argumente apo prova të reja që do të cenonin ligjshmërinë e vendimit të marrë.

Prandaj, **pretendimi ankimor nr. 2 refuzohet si i pabazuar.**

PËRGJIGJE PËR PRETENDIMI ANKIMORE NR 3

Autoriteti Kontraktues, në Dosjen e Tenderit dhe Njoftimin për Kontratë, konkretisht në kuadër të **Kapacitetit Teknik dhe Profesional**, në **Kërkesën 6** të Dosjes së Tenderit, ka kërkuar në mënyrë të qartë që operatori ekonomik të disponojë: **një (1) pajisje gjeodezike GPS GNSS RTK – Advanced Engine System me minimum 1408 kanale satelitore, me dual kamerë në kokë – receiver, controller Handy me kamerë në controller – terminal, me opSION rievimi 3D me fotografi (fotogrametri) dhe me laser, si dhe me mundësinë e modelimit 3D dhe piketimit Real View me kamerë.** Po ashtu, si dëshmi dokumentare është kërkuar të prezantohet **specifikacioni teknik nga prodhuesi i pajisjes**, me qëllim të verifikimit të përmbushjes së kërkesave minimale teknike.

Gjatë vlerësimit të ofertës është konstatuar se Grupi i Operatorëve Ekonomik ka paraqitur pajisjen **HI-Target V600i**. Pas shqyrtimit të dokumentacionit të dorëzuar dhe karakteristikave teknike të kësaj pajisjeje, Komisioni i Vlerësimit ka konstatuar se ajo **nuk i plotëson kërkesat minimale të përcaktuara në Dosjen e Tenderit**, përkatësisht nuk është dëshmuar se pajisja posedon **opsionin e rievimit 3D me fotografi (fotogrametri)** dhe **mundësinë e modelimit 3D**, siç është kërkuar shprehimisht nga Autoriteti Kontraktues.

Nga karakteristikat teknike të pajisjes rezulton se ajo disponon funksion të **matjes me laser**, mirëpo **kamera e integruar shërben vetëm për orientim dhe piketim (Real View/Visual Stakeout) në terren**, dhe jo për kryerjen e rievimit përmes fotogrametrisë

apo për modelim 3D. Për rrjedhojë, funksioni i kamerës nuk mund të konsiderohet ekuivalent me kërkesën e Dosjes së Tenderit për **rilevim 3D me fotografi (fotogrametri) dhe mundësi të modelimit 3D**.

Për më tepër, operatori ekonomik **nuk ka prezantuar specifikacionin teknik nga prodhuesi**, ndonëse kjo ka qenë një kërkesë e qartë dhe e detyrueshme e Dosjes së Tenderit. Në mungesë të këtij dokumenti, Autoriteti Kontraktues nuk ka pasur mundësi të verifikojë përmbushjen e karakteristikave minimale teknike të kërkuara.

Për rrjedhojë, Komisioni i Vlerësimit ka konstatuar drejt se pajisja e ofruar nuk i përmbush kërkesat minimale të Dosjes së Tenderit dhe se operatori ekonomik nuk ka dëshmuar përputhshmërinë teknike të saj me kërkesat e Autoritetit Kontraktues.

Prandaj, **pretendimi ankimor nr. 3 refuzohet si i pabazuar**.

PËRGJIGJE PËR PRETENDIMI ANKIMORE NR 4

Grupi i Operatoreve ekonomik, pretendon se dokumentacioni i paraqitur nga Grupi i Operatorëve Ekonomikë të rekomanduar për kontratë, nuk e përmbush Kërkesën 2.5 të Dosjes së Tenderit, duke u bazuar në pretendimin se nënshkrimi në CV dhe nënshkrimi në kontratën e angazhimit të z. Dukagjin Ramqaj janë të ndryshme dhe, sipas tyre, kjo krijon dyshime për autenticitetin e dokumenteve.

Autoriteti Kontraktues vlerëson se ky pretendim është i pabazuar dhe nuk mbështetet në prova objektive. Komisioni i Vlerësimit ka shqyrtuar dokumentacionin e dorëzuar nga grupi i operatoreve ekonomik i rekomanduar për kontratë dhe ka konstatuar se janë dorëzuar të gjitha dokumentet e kërkuara në Dosjen e Tenderit, përkatësisht diploma, licenca, kontrata e angazhimit, CV-ja e nënshkruar dhe referencat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara.

Pretendimi i GOE bazohet vetëm në një vlerësim subjektiv lidhur me pamjen e nënshkrimeve, pa paraqitur ndonjë provë objektive apo vendim të ndonjë organi kompetent që do të vërtetonte se dokumentet janë të falsifikuara ose se nuk janë nënshkruar nga personi përkatës. Dallimet eventuale në mënyrën e vendosjes së një nënshkrimi nuk përbëjnë, në vetvete, provë të manipulimit apo falsifikimit të dokumenteve.

Autoriteti Kontraktues nuk është organ kompetent për të kryer ekspertiza apo për të konstatuar autenticitetin e nënshkrimeve vetëm mbi bazën e perceptimeve vizuale. Në mungesë të provave konkrete dhe të besueshme që dëshmojnë falsifikim ose manipulim të dokumentacionit, Komisioni i Vlerësimit nuk ka bazë ligjore për të shpallur dokumentet të pavlefshme apo për të eliminuar operatorin ekonomik të rekomanduar për kontratë.

Për rrjedhojë, duke qenë se grupi I operatorëve ekonomik nuk ka paraqitur prova të mjaftueshme që do të vërtetnin pretendimet e tij, ndërsa dokumentacioni i grupit të operatorëve ekonomik të rekomanduar për kontratë është vlerësuar në përputhje me kërkesat e Dosjes së Tenderit, **pretendimi ankimor nr. 4 refuzohet si i pabazuar**.

PËRGJIGJE PËR PRETENDIMI ANKIMORE NR 5

Grupi i Operatoreve ekonomik, pretendon se Grupi i Operatorëve Ekonomikë të rekomanduar për kontratë, nuk i ka përmbushur kërkesat 2.7 dhe 2.9 të Dosjes së Tenderit, me arsyetimin se ekspertët e propozuar nuk posedojnë licenca nga OIEK.

Pas shqyrtimit të dokumentacionit të ofertës, Autoriteti Kontraktues konstaton se ky pretendim nuk qëndron.

Në Dosjen e Tenderit është kërkuar që për pozitën 2.7 të propozohet një Inxhinier i Gjeodezisë ose Bachelor me përvojë pune profesionale minimum 3 vite pas diplomimit dhe për pozitën 2.9 një ekspert me licencë për hartimin e Elaboratit të Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis (VNM), ndërsa si dëshmi dokumentare është kërkuar, ndër të tjera, që stafi profesional të jetë **i licencuar sipas legjislacionit në fuqi**.

Për pozitën sipas pikës **2.7**, është prezantuar licenca e z. **Shaban Hoti**, me nr. **34**, e lëshuar nga **Agjencia Kadastrale e Kosovës**, me vlefshmëri nga **25.02.2026** deri më **25.02.2031**. Kjo licencë është lëshuar nga institucioni kompetent për licencimin e gjeodetëve dhe përmbush kërkesën e Dosjes së Tenderit.

Po ashtu, për pozitën sipas pikës **2.9**, operatori ekonomik i rekomanduar për kontratë ka prezantuar licencën e z. **Adnan Elshani**, me nr. **1/19/24**, të lëshuar nga **Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor**, me vlefshmëri nga **12.08.2024** deri më **11.08.2029**. Kjo licencë është lëshuar nga institucioni kompetent për licencimin e ekspertëve të Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis dhe përmbush plotësisht kërkesën e Dosjes së Tenderit.

Autoriteti Kontraktues vlerëson se kërkesa e Dosjes së Tenderit nuk mund të interpretohet në mënyrë që të kërkojë licenca nga OIEK për profile profesionale për të cilat legjislacioni në fuqi përcakton se licencat lëshohen nga institucione të tjera kompetente. Për këto profile profesionale, licencat valide të lëshuara nga institucionet kompetente sipas legjislacionit në fuqi përmbushin kërkesën e Dosjes së Tenderit.

Për rrjedhojë, dokumentacioni i grupit të operatorëve ekonomik të rekomanduar për kontratë është në përputhje me kërkesat e Dosjes së Tenderit, ndërsa **pretendimi ankimor nr. 5 refuzohet si i pabazuar**.

PËRGJIGJE PËR PRETENDIMI ANKIMORE NR 6

Grupi i Operatoreve ekonomik, pretendon se oferta e Grupit të Operatorëve Ekonomikë të rekomanduar për kontratë, përmban çmime më të larta se çmimet e tregut dhe se Autoriteti Kontraktues nuk ka vepruar në përputhje me parimet e ekonomicitetit dhe efikasitetit gjatë zhvillimit të kësaj procedure të prokurimit.

Pas shqyrtimit të këtij pretendimi, Autoriteti Kontraktues konstaton se ai nuk mbështetet në prova objektive dhe nuk argumenton me fakte konkrete se oferta e operatorit ekonomik të rekomanduar për kontratë është në kundërshtim me Ligjin për Prokurimin Publik, Rregulloren Nr. 001/2022 apo kërkesat e Dosjes së Tenderit.

Komisioni i Vlerësimit ka shqyrtuar dhe vlerësuar ofertat në përputhje me kriteret dhe kërkesat e përcaktuara në Dosjen e Tenderit, duke zbatuar në mënyrë të barabartë standardet e vlerësimit për të gjithë operatorët ekonomikë pjesëmarrës në këtë procedurë. Gjatë procesit të vlerësimit është konstatuar se operatori ekonomik i rekomanduar për kontratë i ka përmbushur të gjitha kërkesat administrative, teknike, profesionale dhe financiare të përcaktuara në Dosjen e Tenderit dhe është vlerësuar në përputhje me kriterin për dhënien e kontratës, përkatësisht **"Çmimi më i ulët me poentim"**.

Pretendimet e operatorit ekonomik nuk provojnë se Komisioni i Vlerësimit ka vepruar në kundërshtim me dispozitat e Ligjit për Prokurimin Publik apo se gjatë procesit të vlerësimit është cenuar ndonjë nga parimet themelore të prokurimit publik. Përkundrazi, procedura është zhvilluar në përputhje me kërkesat e Dosjes së Tenderit, duke siguruar trajtim të barabartë, transparencë dhe vlerësim objektiv të të gjitha ofertave.

Për rrjedhojë, duke qenë se pretendimi ankimor nuk mbështetet në prova konkrete dhe nuk dëshmon ndonjë shkelje të legjislacionit në fuqi apo të kërkesave të Dosjes së Tenderit, **pretendimi ankimor nr. 6 refuzohet si i pabazuar.**

PËRFUNDIM:

Pas shqyrtimit të plotë të kërkesës për rishqyrtim, të gjitha pretendimeve ankimore të paraqitura nga Grupi i Operatorëve Ekonomikë, si dhe pas analizimit të dokumentacionit të ofertave, Dosjes së Tenderit, Njoftimit për Kontratë dhe legjislacionit në fuqi për prokurimin publik, Autoriteti Kontraktues konstaton se **asnjëri nga pretendimet ankimore nuk është i bazuar në fakte dhe prova të mjaftueshme që do të cenonin ligjshmërinë e procesit të vlerësimit apo vendimmarrjes së Komisionit të Vlerësimit.**

Komisioni i Vlerësimit ka zhvilluar procedurën e vlerësimit në përputhje me dispozitat e Ligjit për Prokurimin Publik, Rregullores Nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, Dosjes së Tenderit dhe Njoftimit për Kontratë, duke i trajtuar të gjithë operatorët ekonomikë në mënyrë të barabartë, të paanshme dhe objektive.

Duke u bazuar në kërkesat e njoftimit për kontratë dhe dosjes së tenderit, rezulton se Grupi i Operatorëve ekonomik i rekomanduar për kontratë i ka plotësuar kërkesat e specifikuar në njoftimin për kontratë dhe në dosje të tenderit, dhe në këtë rezulton që ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve është bërë në harmoni të plotë me nenin 59 të LPP-së dhe duke u respektuar edhe të gjitha dispozitat e LPP-së.

Andaj, kërkesa për rishqyrtim e paraqitur nga Grupi i Operatorëve Ekonomikë, refuzohet në tërësi si e pabazuar.

Nga konstatimet e lartcekur u vendos si në dispozitave të këtij Vendimi.

Kjo procedurë është trajtuar konform Ligjit Nr. 04/042, Ligji për Prokurimin Publik ne Republikën e Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-92.

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij **vendimi të AK-së ju mundë të paraqitni** ankesë pranë OSHP-së në pajtim me nenin 109 të LPP-së. Ankesa pranë OSHP-së duhet të dorëzohet brenda 10 (dhjetë) ditëve pas vendimit të lëshuar nga Autoriteti Kontraktues.

Vendimi Publikohet:

Në platformën elektronike në adresën: <https://e-prokurimi.rks-gov.net>